VENDIM
Nr. 256, datë 24.4.2019

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR GRUMBULLIMIN, MENAXHIMIN E PËRDORIMIN E TË DHËNAVE NË SEKTORIN E PESHKIMIT DHE MBËSHTETJEN PËR KËSHILLIMIN SHKENCOR PËR STRATEGJINË KOMBËTARE TË PESHKIMIT[1]

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 93, pikat 4 e 5, e 135, pika 1, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton rregullat për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave biologjike, mjedisore, teknike dhe socio-ekonomike në sektorin e peshkimit, sipas përcaktimeve të nenit 93, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, me qëllim përmbushjen e objektivave të Strategjisë Kombëtare të Peshkimit.

2. Të gjithë termat e përcaktuar në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me ata të përcaktuar në ligjin nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar. Gjithashtu, për efekt të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "Metadata", të dhënat që japin informacione sasiore e cilësore për të dhënat parësore të grumbulluara;

b) "Rajon detar", një zonë gjeografike e përcaktuar nga organizatat rajonale të peshkimit;

c) "Të dhëna shkencore", të dhënat e përcaktuara nga pika 1, e kreut I, të këtij vendimi;

ç) "Të dhëna të përbëra", të dhënat e marra nga përpunimi i të dhënave parësore ose i të dhënave të hollësishme, për qëllime të veçanta;

d) "Vëzhgues shkencor", një person i caktuar për të vëzhguar veprimtarinë e peshkimit në kuadër të procesit të grumbullimit të të dhënave për qëllime shkencore dhe të përzgjedhur sipas përcaktimeve të nenit 125, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar.

KREU II
GRUMBULLIMI DHE MENAXHIMI I TË DHËNAVE NË KUADËR TË PROGRAMIT KOMBËTAR SHUMËVJEÇAR

A
Programi i kampionimit shumëvjeçar

1. Programi kombëtar shumëvjeçar për grumbullimin, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave biologjike, teknike, mjedisore dhe social-ekonomike hartohet për një periudhë trevjeçare.

---

[1]Rregullore (EU) 2017/1004 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 17 maj 2017, për krijimin e një kornize të Bashkimit për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor në lidhje me politikën e përbashkët të peshkimit dhe shfuqizimin e Rregullores (KE) 199/2008 të Këshillit.
Vendim për zbatim i Komisionit (EU) 2016/1251, i 12 korrikut 2016, për miratimin e një programi shumëvjeçar të Bashkimit për mbledhjen, menaxhimin dhe përdorimin e të dhënave në sektorët e peshkimit dhe akuakulturës për periudhën 2017-2019.

2. Përmbajtja e programit të kampionimit shumëvjeçar është parashikuar në shtojcën B, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Programi i kampionimit shumëvjeçar përcakton, si më poshtë vijon:

a) Një listë të detajuar të kritereve që duhet të plotësojnë të dhënat për arritjen e objektivave të Strategjisë Kombëtare të Peshkimit;

b) Një listë të fushatave kërkimore-shkencore, të detyrueshme, në det;

c) Pragjet, poshtë të cilave nuk është e nevojshme të mblidhen të dhëna për aktivitetet e peshkimit dhe të akuakulturës ose për të kryer fushata kërkimore në det.

4. Të dhënat sipas shkronjës "a", të pikës 3, të shkronjës "A", të kreut II, të këtij vendimi, parashikohen në shtojcën A.

5. Plani i kampionimit shumëvjeçar mban parasysh, si më poshtë vijon:

a) nevojën për informacion për menaxhimin e peshkimit të bazuar në qasjen pro ekosistemit, për të siguruar që peshkimi të ketë një ndikim minimal në ekosistemet detare dhe të sigurojë që veprimtaritë e akuakulturës e të peshkimit të shmangin degradimin e mjedisit detar. Ky informacion duhet të mundësojë përcaktimin e objektivave të nevojshëm për zbatimin e planeve të menaxhimit dhe të zbatimit, sipas përcaktimeve të neneve 25 e 26, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar;

b) nevojën për të dhëna të përshtatshme, të plota e të besueshme, me qëllim menaxhimin e peshkimit dhe marrjen e vendimeve për mbrojtjen e ekosistemeve, përfshirë llojet dhe habitatet e rrezikuara;

c) nevojën dhe rëndësinë e të dhënave për zhvillimin e qëndrueshëm të akuakulturës në nivel kombëtar;

ç) nevojën për të mbështetur vlerësimet e ndikimit të masave të ndërmarra në kuadër të politikave sektoriale;

d) kostot dhe përfitimet, duke marrë parasysh zgjidhjet me kosto më efektive, për të arritur qëllimin e grumbullimit të të dhënave;

dh) nevojën për të shmangur ndërprerjen e serive kohore ekzistuese;

e) nevojën për të thjeshtuar e shmangur dyfishimin e mbledhjes së të dhënave, të përcaktuara në pikën 1, të kreut I, të këtij vendimi;

ë) ku është e përshtatshme, nevojën për të dhënat për të mbuluar aktivitetet e peshkimit për të cilat ka mungesë të tyre;

f) detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë;

g) mbulimin hapësirë – kohë të aktivitetit të grumbullimit të të dhënave.

6. Lista e fushatave kërkimore-shkencore, të detyrueshme, në det, sipas shkronjës "b", të pikës 3, të kreut II, të këtij vendimi, hartohet duke mbajtur parasysh këto kërkesa:

a) nevojat për informacion që lindin nga masat menaxhuese ndërkombëtare;

b) nevojat për informacion për vlerësimin e planeve të menaxhimit;

c) nevojat për informacion për monitorimin e variablave të ekosistemeve;

ç) nevojat për informacion për mbulimin e përshtatshëm të zonave të shpërndarjes së popullatave;

d) nevoja për të shmangur dublikimin e fushatave kërkimore në det; dhe

dh) nevojën për të shmangur ndërprerjet e serive kohore.

B
Zbatimi i programit të kampionimit shumëvjeçar

Për miratimin e planit të punës, ministria mban parasysh vlerësimin e bërë nga Komiteti për Koordinimin e Kërkimit Shkencor, Teknik dhe Ekonomik (në vijim, "KKKSHTE"). Kur KKKSHTE-ja vlerëson se plani i punës nuk përputhet me nenin 93, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, ose kur çmon se plani i punës nuk garanton interesin shkencor të të

dhënave ose cilësinë e metodikave dhe procedurave të propozuara, propozon ndryshimet që i duhen bërë planit. Drejtoria përgjegjëse për peshkimin paraqet një plan pune të rishikuar.

1. Plani i punës përmban një përshkrim të detajuar të elementeve, si më poshtë vijon:

a) të dhënat që do të mblidhen, në përputhje me programin kombëtar shumëvjeçar;

b) shpërndarjen hapësinore e kohore dhe frekuencën me të cilën do të mblidhen të dhënat;

c) burimin e të dhënave, procedurat dhe metodikat për mbledhjen e përpunimin e të dhënave dhe marrjen e serive të të dhënave që do t'u ofrohen përdoruesve përfundimtarë të të dhënave shkencore;

ç) sistemin e sigurimit të cilësisë dhe kontrollit të ngritur, për të siguruar cilësi të përshtatshme të të dhënave, në përputhje me pikat 2 e 3, të shkronjës "D", të kreut II, të këtij vendimi;

d) formatin dhe datën, ku të dhënat duhet të vihen në dispozicion të përdoruesve fundorë të të dhënave shkencore, duke marrë parasysh nevojat e treguara nga përdoruesit përfundimtarë të të dhënave shkencore, nëse dihet;

dh) marrëveshjet ndërkombëtare e rajonale të bashkëpunimit dhe koordinimit, duke përfshirë marrëveshjet dypalëshe e shumëpalëshe të përfunduara, për të arritur objektivat e këtij vendimi; dhe

e) Si janë marrë parasysh detyrimet ndërkombëtare.

2. Në përgatitjen e planit kombëtar të punës, brenda grupeve koordinuese rajonale të referuara në pikën 4, të shkronjës "B", të kreut II, të këtij vendimi, bashkërendohen përpjekjet me shtetet e tjera anëtare të organizatave rajonale të menaxhimit të peshkimit dhe bashkëpunon me ta, veçanërisht me ato të të njëjtit rajon detar, në mënyrë që të garantojë mbulim të mjaftueshëm dhe efektiv e për të shmangur dublikimin e aktiviteteve të grumbullimit të të dhënave. Aty ku është e përshtatshme, një bashkëpunim dhe koordinim i tillë mund të bëhet edhe jashtë fushëveprimit të grupeve koordinuese rajonale.

3. Ministria bashkërendon punën për grumbullimin e të dhënave me shtetet e tjera të Adriatikut dhe të Mesdheut ose me shtetet ndërkufitare tokësore.

4. Për lehtësimin dhe bashkërendimin e punës në nivel rajonal, ministria merr pjesë në grupet e koordinimit rajonal, me qëllim hartimin dhe zbatimin e procedurave, metodikave, garancive të cilësisë dhe kontrollin e cilësisë për mbledhjen dhe trajtimin e të dhënave për të përmirësuar më tej besueshmërinë e kështillimit shkencor.

5. Grupet e koordinimit rajonal kanë për qëllim zhvillimin dhe përditësimin e bankës së të dhënave në nivel rajonal.

6. KKKSHTE-ja vlerëson zbatimin e programeve kombëtare dhe cilësinë e të dhënave të mbledhura.

7. Ministria vlerëson zbatimin e programeve kombëtare në bazë të:

a) vlerësimit të KKKSHTE-së;

b) konsultimeve me organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit, ku Shqipëria është palë.

C
Kërkesat në lidhje me procesin e grumbullimit të të dhënave

1. Ministria merr masa për të siguruar që monitoruesit e peshkimit të caktuar për marrjen e mostrave të kryejnë funksionet e tyre, duke pasur akses në të gjitha zëniet, në anije dhe të gjitha vendet e tjera të kampionimit, në të gjithë regjistrat detarë dhe të gjitha të dhënat e nevojshme.

2. Kapitenët e anijeve të peshkimit pranojnë në bord monitoruesit shkencorë dhe do të bashkëpunojnë me ta për të kryer detyrat e tyre gjatë qëndrimit në bord, si dhe aplikimin, sipas rastit, të metodikave alternative të mbledhjes së të dhënave, siç përcaktohet në planet kombëtare të punës.

3. Kapitenët e anijeve të peshkimit mund të refuzojnë të pranojnë në bord monitoruesit e peshkimit e që veprojnë në kuadër të kontrollit në det ose në ujërat e brendshme vetëm në rastet kur mungon hapësira e nevojshme akomoduese në anije ose që lidhen me sigurinë në bord,

sikurse parashikohet në legjislacionin përkatës kombëtar. Në këto raste, të dhënat mblidhen nëpërmjet metodikave alternative të grumbullimit të të dhënave të përcaktuara në planin kombëtar të grumbullimit të të dhënave dhe të miratuara nga KKKSHTE-ja.

D
Procesi i menaxhimit të të dhënave

1. Ministria, në funksion të menaxhimit të të dhënave, ushtron kompetencat, si më poshtë vijon:

a) siguron që të dhënat parësore të mbledhura në kuadër të programit kombëtar të mbahen në mënyrë të sigurt në format të kompjuterizuar dhe merr gjithashtu të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që trajtimi i tyre të jetë konfidencial;

b) siguron që metadatat e lidhura me të dhënat parësore social-ekonomike, të mbledhura në kuadër të programit kombëtar, të mbahen në mënyrë të sigurt në një bazë të dhënash të kompjuterizuar;

c) merr të gjitha masat teknike të nevojshme për të mbrojtur këto të dhëna ndaj çdo aksidenti ose shkatërrimi, humbjeje aksidentale, përkeqësimi, konsulence apo shpërndarjeje të paautorizuar.

2. Drejtoria përgjegjëse për peshkimin, referuar nenit 94, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, është përgjegjëse për cilësinë dhe tërësinë e të dhënave parësore të mbledhura në kuadër të programit kombëtar, sikurse edhe për të dhënat e hollësishme dhe parësore, të cilat u transmetohen përdoruesve finalë.

3. Drejtoria përgjegjëse për peshkimin sigurohet që:

a) të dhënat parësore të mbledhura sipas programit kombëtar të jenë të kontrolluara sipas procedurave të caktuara të kontrollit të cilësisë së tyre;

b) të dhënat e hollësishme dhe të përbëra, që rrjedhin nga të dhënat parësore të mbledhura në kuadër të programit kombëtar, të jenë njëvleftësuar përpara transmetimit të tyre te përdoruesit fundorë;

c) procedurat e garantimit të cilësisë, që zbatohen te të dhënat parësore të hollësishme e të përbëra, sipas shkronjave "a" e "b", të kësaj pike, të jenë kryer në përputhje me procedurat e miratuara nga organizmat shkencorë ndërkombëtarë, organizatat e menaxhimit të peshkimit rajonal dhe KKKSHTE-ja.

KREU III
PËRDORIMI I TË DHËNAVE

1. Ministria merr masa që të dhënat parësore të fushatave të kërkimit të dërgohen pranë organizatave shkencore ndërkombëtare dhe organeve shkencore të përshtatshme në kuadër të organizatave rajonale të peshkimit, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë.

2. Ministria i përpunon të dhënat parësore në një seri të dhënash të detajuara ose të përbëra në përputhje me:

a) rregullat ndërkombëtare më të rëndësishme, nëse është e aplikueshme;

b) marrëveshjet e firmosura në nivel rajonal ose ndërkombëtar, nëse janë të aplikueshme.

3. Ministria vë në dispozicion të përdoruesve fundorë të dhënat shkencore, një përshkrim të metodikave të përdorura për përpunimin e të dhënave të kërkuara dhe të vetive statistikore të këtyre metodikave.

4. Ministria krijon procese dhe teknologji të përshtatshme elektronike për të siguruar zbatimin efektiv të këtij vendimi. Ministria nuk vendos kufizime të panevojshme për shpërndarjen e të dhënave të detajuara dhe të grumbulluara për përdoruesit fundorë të të dhënave shkencore dhe për palët e tjera të interesuara.

5. Ministria siguron garancitë e duhura në rast se të dhënat përfshijnë informacion lidhur me personat fizikë ose juridikë të identifikuar ose të identifikueshëm. Ministria mund të refuzojë transmetimin e të dhënave të detajuara dhe të grumbulluara përkatëse, nëse ekziston rreziku i identifikimit të personave fizikë ose juridikë; në këtë rast, për t'iu përgjigjur nevojave të identifikuara nga përdoruesit fundorë të të dhënave shkencore, ministria mund të propozojë zgjidhje alternative që garantojnë anonimitetin e subjekteve të të dhënave.

6. Në rast se të dhënat shkencore kërkohen nga përdoruesit fundorë, pasi shërbejnë si bazë për dhënien e opinionit lidhur me menaxhimin e peshkimit, ministria siguron që të dhënat përkatëse të detajuara e të grumbulluara të përditësohen dhe t'u vihen në dispozicion përdoruesve fundorë përkatës të të dhënave shkencore, brenda afatit kohor të përcaktuar në kërkesë, i cili nuk duhet të jetë jo më vonë se një muaj nga data e pranimit të kërkesës.

7. Në rast të kërkesave të ndryshme nga ato të përmendura në pikën 3, të kreut III, të këtij vendimi, ministria siguron që të dhënat përkatëse të përditësohen e të vihen në dispozicion të përdoruesve fundorë përkatës të të dhënave shkencore dhe palëve të tjera të interesuara brenda një afati të arsyeshëm kohor. Brenda dy muajve nga data e marrjes së kërkesës, ministria njofton palën kërkuese për këtë afat, që është proporcional me fushëveprimin e kërkesës, si dhe nevojën e mundshme për përpunimin e mëtejshëm të të dhënave të kërkuara.

8. Në rast të kërkesës për të dhëna të detajuara për qëllime të publikimit shkencor, për të mbrojtur interesat profesionalë të monitoruesve të të dhënave në kuadër të zbatimit të planit kombëtar të punës, ministria mund të kërkojë që të dhënat të publikohen vetëm tre vjet pas datës në të cilën kërkuesit i referohen. Ministria informon përdoruesit fundorë të të dhënave shkencore për çdo vendim për këtë qëllim dhe arsyet e një vendimi të tillë.

9. Me qëllim uljen e kostove dhe për të lehtësuar qasjen në të dhëna të detajuara e të përbëra për përdoruesit fundorë të të dhënave shkencore dhe palët e tjera të interesuara, ministria dhe përdoruesit fundorë të të dhënave shkencore në fjalë bashkëpunojnë për të zhvilluar mënyrat e mbajtjes dhe shkëmbimit të të dhënave në përputhje me njëra-tjetrën. Këto sisteme lehtësojnë gjithashtu përhapjen e informacionit te palët e tjera të interesuara. Këto sisteme mund të marrin formën e bazave të të dhënave rajonale.

10. Në rast refuzimi të dhënies së të dhënave për peshkimin sipas pikës 8, të kreut III, të këtij vendimi, përdoruesit fundorë mund të ankohen në ministri. Nëse ministria çmon se refuzimi nuk ka qenë i justifikuar, atëherë të dhënat u jepen përdoruesve fundorë brenda një muaji.

11. Përdoruesit fundorë:

a) përdorin të dhënat vetëm për qëllimet e parashikuara në kërkesën e tyre;

b) citojnë në mënyrë korrekte burimin e të dhënave;

c) janë përgjegjës për përdorimin korrekt të të dhënave lidhur me etikën shkencore sipas rregullave dhe legjislacionit në fuqi;

ç) informojnë drejtorinë lidhur me problemet që mund të kenë të dhënat;

d) u japin drejtorisë përgjegjëse për peshkimin dhe ministrisë rezultatet e nxjerra nga përdorimi i tyre;

dh) nuk u dërgojnë të dhëna palëve të treta pa miratimin e ministrisë;

e) nuk shesin të dhënat te palët e treta.

12. Kur përdoruesi fundor i të dhënave shkencore ose një palë tjetër e interesuar nuk përmbush një nga detyrimet e përcaktuara në pikën 11, të kreut III, të këtij vendimi, drejtoria përgjegjëse për peshkimin kufizon ose refuzon përdorimin e të dhënave nga këta përdorues.

KREU IV
MBËSHTETJA PËR KËSHILLIMIN SHKENCOR

1. Ministria siguron që ekspertët kombëtarë të marrin pjesë në mbledhjet përkatëse të organizatave rajonale të menaxhimit të peshkimit, ku Shqipëria është palë kontraktuese ose vëzhguese, si dhe në organizmat e rëndësishëm shkencorë ndërkombëtarë.

2. Drejtoria përgjegjëse për peshkimin bashkërendon punën dhe bashkëpunon me shtetet e tjera, me qëllim përmirësimin e cilësisë e të besueshmërisë së gjykimeve shkencore, cilësisë së programeve dhe metodikave të punës, në përputhje me standardet e organizatave rajonale të menaxhimit të peshkimit, ku Shqipëria është palë kontraktuese ose vëzhguese, si dhe në organizmat e rëndësishëm shkencorë ndërkombëtarë.

3. Ky bashkëpunim zhvillohet pa përjashtuar debatet shkencore të hapura dhe që kanë për qëllim promovimin e një gjykimi shkencor të pavarur.

KREU V
DISPOZITAT E FUNDIT

1. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, vendimi nr. 301, datë 10.4.2013, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave për grumbullimin, menaxhimin e përdorimin e të dhënave në sektorin e peshkimit dhe mbështetjen për këshillimin shkencor për Strategjinë Kombëtare të Peshkimit", shfuqizohet.

2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

SHTOJCA A
TË DHËNAT SIPAS SHKRONJËS "A", TË PIKËS 3, TË SHKRONJËS "A", TË KREUT II, TË KËTIJ VENDIMI

Të dhënat sipas shkronjës "a", të pikës 3, të shkronjës "A", të kreut II, të këtij vendimi, përfshijnë, si më poshtë vijon:

a) të dhënat biologjike për të gjitha resurset që peshkohen ose të peshkuara dhe jo objekt peshkimi, të peshkuara qoftë në ujërat e Republikës së Shqipërisë ose jashtë tyre, në kuadër të peshkimit tregtar dhe, kur është e përshtatshme, edhe të peshkimit çlodhës argëtues, duke përfshirë ngjalën në ujërat e brendshme përkatëse, si dhe speciet e tjera të peshkut me interes tregtar, për të mundësuar një qasje pro ekosistemit për menaxhimin dhe mbrojtjen e peshkimit, me qëllim zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Peshkimit;

b) të dhënat që shërbejnë për vlerësimin e ndikimit të veprimtarisë së peshkimit në ekosistemin detar në ujërat jashtë Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë të dhënat për zëniet e specieve jo objekt peshkimi, veçanërisht për llojet e mbrojtura sipas legjislacionit shqiptar ose të atij ndërkombëtar, të dhënat e ndikimit të aktivitetit të peshkimit në habitatet detare, duke përfshirë zonat detare të rrezikuara dhe të dhëna për ndikimet e aktiviteteve të peshkimit në zinxhirin ushqimor;

c) të dhënat për aktivitetin e peshkimit, që përfshijnë edhe shkallën e sforcos së peshkimit e të kapacitetit të peshkimit;

ç) të dhënat socio-ekonomike për peshkimin, me qëllim vlerësimin e rezultateve social-ekonomike të sektorit të peshkimit;

d) të dhënat social-ekonomike dhe të dhënat lidhur me qëndrueshmërinë e akuakulturës detare, për të mundësuar vlerësimin social-ekonomik dhe qëndrueshmërinë e këtij sektori e lidhur kjo edhe me ndikimin në mjedis;

dh) të dhënat social-ekonomike të sektorit të industrisë përpunuese të prodhimeve peshkore, për të mundësuar vlerësimin social-ekonomik të këtij sektori.

Gjithashtu, të dhënat e përmendura në shkronjën "a", të pikës 3, të shkronjës "A", të kreut II, të këtij vendimi, përfshijnë të dhëna socio-ekonomike dhe të dhëna për qëndrueshmërinë e akuakulturës së ujërave të brendshme, për të mundësuar vlerësimin e rezultateve socio-

ekonomike dhe të qëndrueshmërisë së sektorit të akuakulturës të ujërave të brendshme, duke përfshirë edhe ndikimin e tij në mjedis.

SHTOJCA B
PROGRAMI I KAMPIONIMIT SHUMËVJEÇAR

KAPITULLI I
PËRKUFIZIMET

Në këtë shtojcë termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Anijet aktive", anije që kanë kryer veprimtari peshkimi (një ditë ose më shumë) gjatë një viti kalendarik. Një anije që nuk ka kryer veprimtari peshkimi gjatë një viti konsiderohet "jo aktive".

2. "Ditë në det", çfarëdolloj periudhe e pandarë prej 24 (njëzetekatër) orësh (ose pjesë e saj), përgjatë së cilës një anije peshkimi ndodhet në brendësi të një zone peshkimi dhe është jashtë portit.

3. "Ditë peshkimi", ditë kalendarike në det, kur është kryer një operacion peshkimi, pa shkelur detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë. Një dalje në det mund të jetë qoftë shuma e ditëve të peshkimit në rastet e mjeteve pasive, ashtu edhe shuma e ditëve të peshkimit për mjetet aktive gjatë asaj daljeje në det.

4. "Fraksion i zënieve", një pjesë e sasisë së përgjithshme të zënë, p.sh. pjesa e zënieve të zbarkuara mbi dimensionet minimale të lejuara, pjesa e zënieve të zbarkuara nën dimensionet minimale të lejuara, pjesa e hedhur në det nën dimensionet minimale të lejuara, hedhurinat minimale dhe hedhurinat në tërësi.

5. "Fushatat kërkimore në det", daljet e kryera në një anije kërkimore-shkencore ose në një anije të përdorur për kërkim shkencor për monitorimin e stoqeve dhe ekosistemeve e të caktuara për këtë detyrë nga organi përgjegjës për zbatimin e planit kombëtar të punës të përcaktuar nga ky vendim.

6. "Profesion", një grup i operacioneve të peshkimit që gjuajnë specie të ngjashme (ose bashkësi speciesh), duke përdorur mjete të ngjashme peshkimi gjatë së njëjtës periudhë të vitit dhe/ose në të njëjtën zonë, të cilat karakterizohen nga një model i ngjashëm shfrytëzimi.

7. "Segmenti i flotës", grup i anijeve me të njëjtën klasë gjatësi (LOA, gjatësia e përgjithshme) dhe që zakonisht përdorin të njëjtin mjet peshkimi gjatë vitit.

8. "Speciet anadrome", burime ujore të gjalla, ciklet jetësore të të cilave fillojnë me çeljen e vezëve në ujëra të ëmbla dhe vazhdon me migrimin në ujërat detare, kthimin dhe në fund riprodhimin në ujërat e ëmbla.

9. "Speciet katadrome", burime ujore të gjalla, ciklet jetësore të të cilave fillojnë me çeljen vezëve në ujëra të kripura dhe vazhdon me migrimin në ujërat e ëmbla, kthimin dhe në fund riprodhimin në ujërat e kripura.

10. "Zonat e peshkimit", bashkësia e njësive gjeografike, ku kryhet peshkimi. Këto njësi duhet të rregullohen në nivel rajoni detar në bazë të zonave ekzistuese të përcaktuara nga organizatat rajonale të menaxhimit të peshkimit ose organet shkencore.

KAPITULLI II
METODIKAT E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE

Metodikat dhe cilësia e mbledhjes së të dhënave duhet të jenë në përputhje me nenin 23, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, dhe duhet të ndjekin praktikat më të mira dhe metodologjitë përkatëse të këshilluara nga organet shkencore. Për këtë qëllim, metodikat dhe rezultati i zbatimit të metodikave shqyrtohen në intervale të rregullta nga organet e pavarura

shkencore, me qëllim që të verifikojnë përshtatshmërinë e tyre me respektimin e politikës së menaxhimit të peshkimit.

KAPITULLI III
KËRKESAT NË LIDHJE ME TË DHËNAT

1. Grupet e të dhënave

1.1 Bazuar në planin e punës për grumbullimin e të dhënave të hartuar nga ministria, të dhënat mblidhen ndërmjet grupeve të mëposhtme të specifikuara, që përcaktohen në pikat 2 deri në 7, të këtij kapitulli:

a) të dhënat biologjike, të mbledhura për të vlerësuar gjendjen e popullatave të shfrytëzuara nga pjesa e zënieve, si brenda dhe jashtë ujërave të Republikës së Shqipërisë, si dhe nga peshkimi çlodhës argëtues në ujërat e Republikës së Shqipërisë;

b) të dhënat për të vlerësuar ndikimin e peshkimit shqiptar në ekosistemin detar në ujërat e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë ujërave të saj;

c) të dhëna të hollësishme për veprimtarinë e anijeve të peshkimit shqiptar në ujërat e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë ujërave të Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimeve të nenit 93, të ligjit 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar;

ç) të dhënat sociale dhe ekonomike për peshkimin;

d) të dhënat sociale, ekonomike dhe mjedisore të akuakulturës;

1.2 Të dhënat që mblidhen përcaktohen në përputhje me shkronjën "A", të kreut II, dhe të shtojcës B, të këtij vendimi.

1.3 Të dhënat grumbullohen për të siguruar vlerësime të vlefshme për llojin e peshkimit, periudhat kohore dhe zonat në bazë të nevojave të përdoruesve bazë të dakordësuara në nivel rajonal detar. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave duhet të koordinohet në nivel rajonal, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë shtojcë dhe në tabelat përkatëse.

2. Të dhënat biologjike për stoqet e zënieve nga peshkimi tregtar shqiptar brenda dhe jashtë ujërave të saj, si dhe nga peshkimi çlodhës argëtues në ujërat e Republikës së Shqipërisë

Këto të dhëna përbëhen nga:

a) sasia e zënieve sipas llojeve dhe e të dhënave biologjike nga mostra individuale që mundësojnë vlerësimin e:

i. Për peshkimin tregtar, frekuencës së volumit dhe të gjatësisë së të gjitha sasive të kapura (duke përfshirë hedhurinat dhe kapjet e padëshiruara) për stoqet e listuara në tabelat 1A e 1B, të raportuara në nivelin e grumbullimit 6, siç është paraqitur në tabelën 2. Frekuenca kohore duhet të koordinohet në nivel rajonal detar në bazë të nevojave të përdoruesve fundorë;

ii. Për peshkimin tregtar, peshës mesatare dhe shpërndarjes së klasës, moshës së zënieve të stoqeve të listuara në tabelat 1A e 1B. Përzgjedhja e stoqeve nga të cilat duhet të mblidhen këto variabla dhe frekuenca kohore koordinohet në nivel rajonal detar në bazë të nevojave të përdoruesve fundorë;

iii. Për të dhënat e peshkimit tregtar, raportit gjinor, pjekurisë seksuale dhe pjellorisë së stoqeve të listuara në tabelat 1A e 1B të zënieve në frekuencat e nevojshme për analizë shkencore. Përzgjedhja e stoqeve nga të cilat këto variabla duhet të mblidhen dhe frekuenca kohore do të koordinohet në nivel rajonal detar bazuar në nevojat e përdoruesve fundorë;

iv. Për peshkimin çlodhës argëtues, vëllimit vjetor (numrat dhe peshat ose gjatësinë) të zënieve dhe lëshimeve për speciet e listuara në tabelën 3 dhe/ose speciet e identifikuara në nivel rajoni detar sipas nevojës për menaxhimin e peshkimit. Nevojat e përdoruesve fundorë për moshën ose të dhëna të tjera biologjike, siç përcaktohet në paragrafët "i" – "iii", do të vlerësohen për peshkimin çlodhës argëtues në nivel rajonal detar;

b) përveç të dhënave të grumbulluara nën shkronjën "a", të dhënat për speciet anadrome dhe katadrome të renditura në tabelën 1E të zëna nga peshkimi tregtar gjatë ciklit të tyre të jetës në ujërat e ëmbla, pavarësisht nga mënyra se si është kryer peshkimi, janë, si më poshtë vijon:

i. variabla të lidhura me stoqet (për mostra individuale mbi moshën, gjatësinë, peshën, gjininë, pjekurinë dhe pjellorinë, sipas fazës së jetës, por të specifikuara më tej në bazë specieje dhe rajonale); dhe

ii. sasitë vjetore të zënieve sipas klasifikimit të moshës ose fazës së jetës.

c) përveç kësaj, për ngjalën, informacioni (p.sh.: të dhënat, vlerësimet, tendencat relative etj.), që grumbullohet çdo vit, në të paktën një pellg lumor për njësi të menaxhimit të ngjalës, përfshin:

i. abondancën e rekrutëve;

ii. abondancën e stokut (ngjala e verdhë); dhe

iii. numri ose pesha dhe raporti gjini i ngjalave të argjendta që emigrojnë;

Përcaktimi i lumenjve që duhet të monitorohen për ngjalën përcaktohet në nivel rajonal. Përzgjedhja e stoqeve nga të cilat këto variabla duhet të mblidhen dhe të koordinohet në nivel rajonal bazuar në nevojat e përdoruesve fundorë.

3. Të dhëna për të vlerësuar ndikimin e peshkimit në ekosistemet detare brenda dhe jashtë ujërave të Republikës së Shqipërisë

Këto të dhëna përbëhen nga:

a) për të gjitha llojet e peshkimit, kapjet e rastësishme të të gjithë zogjve, gjitarëve dhe zvarranikëve e peshqve të mbrojtur, sipas legjislacionit shqiptar dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, duke përfshirë llojet e listuara në tabelën 1D, përfshirë mungesën në kapje, gjatë udhëtimeve vëzhguese shkencore në anijet e peshkimit ose nga vetë peshkatarët përmes ditarëve të anijeve të peshkimit.

Kur të dhënat e grumbulluara gjatë fushatave të vëzhguesve vlerësohen se nuk ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për incidentet e rastësishme, për nevojat e përdoruesve fundorë, zbatohen metodologji të tjera. Përzgjedhja e këtyre metodologjive koordinohet në nivel rajonal detar dhe bazohet te nevojat e përdoruesve fundorë.

b) të dhëna për të ndihmuar në vlerësimin e ndikimit të peshkimit brenda dhe jashtë ujërave të Republikës së Shqipërisë në habitatet detare.

Variablat e përdorur për vlerësimin e ndikimit të peshkimit në habitatet detare janë ato të regjistruara sipas nenit 82, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar. Të dhënat do të disagregohen në nivelin e aktivitetit të peshkimit 3 (sipas tabelës 2), përveç rasteve kur kërkohet një nivel më i ulët i grumbullimit të të dhënave në nivel rajonal, veçanërisht në rastin e zonave të mbrojtura detare.

Në rastet kur të dhënat e grumbulluara sipas ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, nuk ofrojnë nivelin e duhur të detajimit ose nuk janë të cilësisë ose të mbulimit të mjaftueshëm për përdorimin shkencor të parashikuar, ato do të mblidhen në mënyrë alternative, duke përdorur metoda të përshtatshme të kampionimit. Të dhënat e grumbulluara sipas ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, u vihen në dispozicion institucioneve kombëtare që zbatojnë planet e punës.

c) të dhënat për vlerësimin e nivelit të peshkimit dhe ndikimin e aktivitetit të peshkimit në burimet biologjike detare dhe në ekosistemet detare, si: efektet në speciet jotregtare, marrëdhëniet pre-grabitqar dhe vdekshmëria natyrore e specieve të peshkut në secilin rajon detar.

Këto të dhëna do të vlerësohen, së pari, në kuadër të studimeve pilot. Bazuar në rezultatet e studimeve pilot, ministria do të përcaktojë grumbullimin e ardhshëm të të dhënave specifike për secilin rajon detar, të koordinuar në nivel rajoni detar dhe në bazë të nevojave të përdoruesve fundorë.

4. Të dhëna të detajuara për veprimtarinë e anijeve të peshkimit shqiptare brenda dhe jashtë ujërave të Republikës së Shqipërisë

Të dhënat për të vlerësuar veprimtarinë e anijeve të peshkimit shqiptar brenda dhe jashtë ujërave të Republikës së Shqipërisë përbëhen nga variablat e treguar në tabelën 4. Të dhënat që

regjistrohen, raportohen dhe transmetohen sipas ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, u vihen në dispozicion, në formën e të dhënave parësore, institucioneve kombëtare që zbatojnë planet e punës.

Kur këto të dhëna mblidhen në mënyrë tjetër ose kur të dhënat e mbledhura sipas ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, nuk kanë detajimin e duhur ose nuk ofrojnë cilësi ose mbulim të mjaftueshëm për përdorimin shkencor të synuar, ato do të mblidhen në mënyrë alternative, duke përdorur metoda të përshtatshme të kampionimit. Këto metoda duhet të lejojnë vlerësimin e variablave të listuara në tabelën 4 në nivelin më të ulët gjeografik përkatës, sipas segmentit të flotës (tabela 5A) dhe nivelit të formës së peshkimit 6 (tabela 2).

5. Të dhënat sociale dhe ekonomike për peshkimin për vlerësimin e performancës sociale dhe ekonomike të sektorit të peshkimit në Shqipëri

Këto të dhëna përbëhen nga:

a) variablat ekonomikë, siç tregohet në tabelën 5A, sipas segmentimit të sektorit në tabelën 5b dhe sipas rajoneve siç përcaktohet në tabelën 5C.

Popullata do të jenë të gjitha anijet aktive dhe joaktive të regjistruara në Regjistrin e Anijeve të Peshkimit, sipas nenit 32, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, deri më 31 dhjetor të vitit raportues.

Për mjetet joaktive mblidhen vetëm vlera e kapitalit dhe kostoja kapitale.

Në rastet kur ekziston rreziku i identifikimit të personave fizik, dhe/ose personave juridikë, mund të përdoren grupimi i të dhënave për të raportuar variabla ekonomikë me qëllim të sigurimit të konfidencialitetit statistikor. Grupimi, gjithashtu, mund të përdoret, nëse është e nevojshme, për të hartuar një plan statistikor të efektshëm të kampionimit. Një skemë e tillë grumbullimi duhet të jetë e qëndrueshme me kalimin e kohës.

Të dhënat ekonomike do të mblidhen në baza vjetore.

b) variablat socialë, siç tregohen në tabelën 6.

Të dhënat sociale do të mblidhen çdo tre vjet duke filluar nga viti 2019.

Të dhënat për punësimin sipas nivelit të arsimit dhe punësimit mund të mblidhen në bazë të studimeve pilot.

6. Të dhënat sociale, ekonomike dhe mjedisore për akuakulturën detare, dhe akuakulturën e ujërave të ëmbla, për të mundësuar vlerësimin e performancës sociale, ekonomike dhe mjedisore të sektorit të akuakulturës

Këto të dhëna përbëhen nga:

a) variablat ekonomikë, siç tregohet në tabelën 7 në bazë sektori të paraqitura në tabelën 9.

Popullata do të përfshijë të gjitha ndërmarrjet, veprimtaria primare e të cilave është përcaktuar sipas klasifikimit evropian të aktiviteteve ekonomike të NACE (9) të kodeve 03.21 dhe 03.22 dhe që klasifikohen si akuakulturë në shkallë të vogël.

Të dhënat ekonomike do të mblidhen në baza vjetore.

b) variablat socialë, siç tregohen në tabelën 6.

Të dhënat sociale do të mblidhen çdo tre vjet duke filluar nga viti 2019.

Të dhënat për punësimin sipas nivelit të arsimit dhe punësimit mund të mblidhen në bazë të studimeve pilot.

c) të dhënat mjedisore për akuakulturën, siç tregohet në tabelën 8, për të mundësuar vlerësimin e aspekteve të performancës së saj mjedisore.

Të dhënat mjedisore mund të mblidhen në bazë të studimeve pilot dhe të llogariten për të treguar të dhënat totale që lidhen me vëllimin e përgjithshëm të peshkut të prodhuar.

Të dhënat mjedisore mblidhen çdo dy vjet.

KAPITULLI IV
FUSHATAT KËRKIMORE NË DET

Fushatat kërkimore në det janë të listuara në tabelën 10.

TË DHËNAT BIOLOGJIKE

Tabela 1A

Speciet në ujërat shqiptare

Speciet (emri shqip)	Speciet (emri shkencor)	Zona ku gjendet stoku
Deti Mesdhe		
Ngjala	Anguilla anguilla	Adriatik dhe Jon
Karkaleci gjigand i kuq	Aristeomorpha foliacea	Adriatik dhe Jon
Karkaleci violetë	Aristeus antennatus	Adriatik dhe Jon
Korifena	Coryphaena equiselis	Adriatik dhe Jon
Korifena	Coryphaena hippurus	Adriatik dhe Jon
Levreku	Dicentrarchus labrax	Adriatik dhe Jon
Açuge	Engraulis encrasicolus	Adriatik dhe Jon
Totanët	Illex spp., Todarodes spp.	Adriatik dhe Jon
Kallamar i butë	Loligo vulgaris	Adriatik dhe Jon
Merluci	Merluccius merluccius	Adriatik dhe Jon
Barbun	Mullus barbatus	Adriatik dhe Jon
Barbun balte	Mullus surmuletus	Adriatik dhe Jon
Oktapodi	Octopus vulgaris	Adriatik dhe Jon
Skampi	Nephrops norvegicus	Adriatik dhe Jon
Gjel	Pagellus erythrinus	Adriatik dhe Jon
Karkalec thellësie	Parapenaeus longirostris	Adriatik dhe Jon
Karkalec toke	Penaeus kerathurus	Adriatik dhe Jon
Sardele	Sardina pilchardus	Adriatik dhe Jon
Skumbri	Scomber spp.	Adriatik dhe Jon
Sepie	Sepia officinalis	Adriatik dhe Jon
Soljola	Solea vulgaris	Adriatik dhe Jon
Koce	Sparus aurata	Adriatik dhe Jon
Maridhat	Spicara smaris	Adriatik dhe Jon
Gjinkallë	Squilla mantis	Adriatik dhe Jon
Stavridat	Trachurus mediterraneus	Adriatik dhe Jon
Stavridat	Trachurus trachurus	Adriatik dhe Jon
Gjel i hirtë	Trigla lucerna	Adriatik dhe Jon
Vongole	Veneridae	Adriatik dhe Jon
Peshk lakuriq	Trisopterus minutus	Adriatik dhe Jon
Të gjithë peshkaqenët dhe rajatë e lejuara të peshkohen	Selachii, Rajidae	Adriatik dhe Jon

TË DHËNAT BIOLOGJIKE

Tabela 1B

Stoqet në rajonet detare nën menaxhimin e organizatave rajonale të menaxhimit të peshkimit (RFMOS)

ICCAT (Komisioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Tonit të Atlantikut)

SPECIET **Gjatë hartimit të planeve të marrjes së mostrave për mbledhjen e informacionit biologjik duhet të merren parasysh kufijtë e stokeve, siç përcaktohen nga RFMOS kompetente.**				**Frekuenca e mbledhjes së variablave biologjikë**
Speciet (emri shkencor)	Speciet (emri shqip)	Zona gjeografike	Prioriteti	Mbledhja e të dhënave është vjetore dhe përditësimi / përpunimi i të dhënave duhet të bëhet në kohë për të përshtatur orarin e vlerësimeve të stokut.
Thunnus albacares	Toni pendëverdhë	Oqeani Atlantik dhe detet pranë tij	i lartë	

Thunnus obesus	Symadhi	Oqeani Atlantik dhe detet pranë tij	i lartë	
Katsuwonus pelamis	Palamidi	Oqeani Atlantik dhe detet pranë tij	i lartë	
Thunnus alalunga	Ton pendëgjatë	Oqeani Atlantik dhe detet pranë tij	i lartë	
Thunnus thynnus	Toni i kuq	Oqeani Atlantik dhe detet pranë tij	i lartë	
Xiphias gladius	Peshku shtizë	Oqeani Atlantik dhe detet pranë tij	i lartë	
Prionace glauca	Peshkaqen blu	Oqeani Atlantik dhe detet pranë tij	i lartë	
Auxis rochei	Trupi	Oqeani Atlantik dhe detet pranë tij	i lartë	
Sarda sarda	Palamidi	Oqeani Atlantik dhe detet pranë tij	i lartë	
Euthynnus alleteratus	Toni i vogël	Oqeani Atlantik dhe detet pranë tij	mesatar	
Orcynopsis unicolor	Palamid i bardhë	Oqeani Atlantik dhe detet pranë tij	mesatar	
Auxis thazard	Trup	Oqeani Atlantik dhe detet pranë tij	mesatar	
Coryphaena hippurus	Korifena	Oqeani Atlantik dhe detet pranë tij	mesatar	

TË DHËNAT BIOLOGJIKE

Tabela 1D

Speciet që duhet të monitorohen sipas programeve të mbrojtjes në Shqipëri ose sipas detyrimeve ndërkombëtare

Speciet (emri shqip)	Speciet (emri shkencor)	Zona	Baza ligjore
Peshq kockorë	Teleostei		
Bli	Acipenser spp.	Deti Mesdhe	Aneksi II Konventa e Barcelonës ligji nr. 64/2012
Sargua bishtzi	Diplodus annularis	Deti Mesdhe	VKM nr. 402, datë 8.5.2013
Sharani	Diplodus puntazzo	Deti Mesdhe	VKM nr. 402, datë 8.5.2013
Sargua i bardhë	Diplodus sargus	Deti Mesdhe	VKM nr. 402, datë 8.5.2013
Sargua	Diplodus vulgaris	Deti Mesdhe	VKM nr. 402, datë 8.5.2013
Kerrat	Epinephelus spp.	Deti Mesdhe	VKM nr. 402, datë 8.5.2013
Murra me rripa	Lithognathus mormyrus	Deti Mesdhe	VKM nr. 402, datë 8.5.2013
Mormuri i egër	Pagellus acarne	Deti Mesdhe	VKM nr. 402, datë 8.5.2013
Spalce e kuqe	Pagellus bogaraveo	Deti Mesdhe	VKM nr. 402, datë 8.5.2013
Pagri i zakonshëm	Pagrus pagrus	Deti Mesdhe	VKM nr. 402, datë 8.5.2013
Kerr fundi	Polyprion americanus	Deti Mesdhe	VKM nr. 402, datë 8.5.2013
Peshkaqen i hirte	Carcharhinus plumbeus	Deti Mesdhe	ORMP, prioritet i lartë, aneksi II Konventa e Barcelonës
Peshkaqen tigër	Carcharias taurus	Deti Mesdhe	ORMP, prioritet i lartë, aneksi II Konventa e Barcelonës
Peshkaqen njeringrënës	Carcharodon carcharias	Deti Mesdhe	ORMP, prioritet i lartë
Peshk derr	Centrophorus granulosus	Deti Mesdhe	ORMP, prioritet i lartë, aneksi IIIKonventa e Barcelonës
Peshqit derr	Centrophorus spp.	Deti Mesdhe	Rëndësishëm deti i thellë
Peshk qen	Galeorhinus galeus	Deti Mesdhe	ORMP, prioritet i lartë, aneksi II Konventa e Barcelonës

Peshkaqen gojëzi	Galeus melastomus	Deti Mesdhe	ORMP, prioritet i lartë, rëndësishëm deti i thellë
Aeroplankë	Gymnura altavela	Deti Mesdhe	ORMP, prioritet i lartë, aneksi II Konventa e Barcelonës
Peshkaqen me dhembe	Heptranchias perlo	Deti Mesdhe	ORMP, prioritet i lartë, aneksi III Konventa e Barcelonës
Peshkaqeni kokështypur	Hexanchus griseus	Deti Mesdhe	ORMP, prioritet i lartë, aneksi II Konventa e Barcelonës
Peshkaqen tonil	Isurus oxyrinchus	Deti Mesdhe	ORMP, prioritet i lartë
Tonil	Lamna nasus	Deti Mesdhe	ORMP, prioritet i lartë,
Raje e rrumbullaket	Leucoraja circularis	Deti Mesdhe	ORMP, prioritet i lartë, aneksi II Konventa e Barcelonës
Pëllumb	Mustelus asterias	Deti Mesdhe	ORMP, prioritet i lartë, aneksi III Konventa e Barcelonës
Pëllumb	Mustelus mustelus	Deti Mesdhe	ORMP, prioritet i lartë, aneksi III Konventa e Barcelonës
Pëllumb	Mustelus punctulatus	Deti Mesdhe	ORMP, prioritet i lartë, aneksi III Konventa e Barcelonës
Peshkaqen balenë	Rhincodon typus	Deti Mesdhe	ORMP, prioritet i lartë
Peshk kitarë	Rhinobatos cemiculus	Deti Mesdhe	ORMP, prioritet i lartë, aneksi II Konventa e Barcelonës
Peshk kitarë	Rhinobatos rhinobatos	Deti Mesdhe	ORMP, prioritet i lartë, aneksi II Konventa e Barcelonës
Raxha e bardhë	Rostroraja alba	Deti Mesdhe	ORMP, prioritet i lartë, aneksi II Konventa e Barcelonës
Peshkaqen gjembor	Squalus acanthias	Deti Mesdhe	ORMP, prioritet i lartë, aneksi III Konventa e Barcelonës
Skadhina	Squatina oculata	Deti Mesdhe	ORMP, prioritet i lartë, aneksi II Konventa e Barcelonës
Skadhina	Squatina squatina	Deti Mesdhe	ORMP, prioritet i lartë, aneksi II Konventa e Barcelonës
Kavall deti	Petromyzon marinus	Deti Mesdhe	VKM nr. 402, datë 8.5.2013
Lampreta	Lampetra fluviatilis	Deti Mesdhe	VKM nr. 402, datë 8.5.2013
Gjitarët	Mammalia		
Cetacetë të gjitha speciet	Cetacea — të gjitha speciet	Deti Mesdhe	Ligji nr. 64/2012
Reptilët	Reptilia		Ligji nr. 64/2012
Krustacetë	Crustacea		
Karavidhe	Homarus gammarus	Mediterranean Sea	VKM nr. 402, datë 8.5.2013
Skampi	Palinuridae	Deti Mesdhe	VKM nr. 402, datë 8.5.2013
Knidarët	Cnidaria	Deti Mesdhe	
Koral i kuq	Corallium rubrum	Deti Mesdhe	Rec. GFCM/36/2012/1 & Rec. GFCM/35/2011/2 Ligji nr. 64/2012

Për llojet e përfshira në listën e kuqe të florës dhe të faunës së egër do të përdoren vetëm individë të kapur të ngordhur. Ato do të hidhen pas matjeve.

TË DHËNAT BIOLOGJIKE

Tabela 1E

Llojet e ujërave të ëmbla Anadrome dhe Katadrome

Speciet (emri shqip)	Speciet (emri shkencor)	Zona jodetare ku ndodhet stoku
Ngjala	Anguilla anguilla	Plan i menaxhimit të ngjalës

Tabela 2

Aktiviteti i peshkimit (profesioni) sipas rajonit

Aktiviteti	Kategoria e veglave	Grupi i veglave	Lloji i veglave	Grupi i specieve objekt peshkimi (a)	Dimensionet e syzeve dhe e mjeteve të tjera selektive	< 6	6 < 12	12- < 18	18- < 24	24- < 40	40 & +
Aktiviteti i peshkimit	Dragat	Draga	Draga të tërhequra nga anijet(DRB)	Specie katadrome Specia anadrome Peshq fundorë Specie fundore Specie të thellësive Grupe të përziera të specieve fundore dhe specie të ujit të thellë(C) Grupe të përziera të specieve fundore e pelagjike Peshk pelagjik të vegjël Peshk me pende Cefalopodë Peshk të mëdhenj pelagjik Peshq pelagjik të vegjël e të mëdhenj Molusqe	(b)						
	Rrjeta tërheqëse	Rrjeta fundore	Rrjeta fundore me timon		(b)						
					(b)						
			Rrjeta të tërhequra me timon dhe multillojesh (OTT)		(b)						
			Rrjeta fundore çift		(b)						
			Tratë sfogliara		(b)						
		Rrjeta tërheqëse pelagjike	Rrjeta tërheqëse pelagjike e me timon		(b)						
			Rrjeta tërheqëse pelagjike e çift		(b)						
	Grepa e linja	Grepa dhe kallama	Grepat e dorës dhe grepat e kallamave		(b)						
			Grepa tërheqës		(b)						
		Pallangare	Pallangare tërheqës		(b)						
			Pallangare fiks		(b)						
	Kurthe	Kurthe	- - - - d h e kurthe		(b)						
			Gogola		(b)						
					(b)						
			Rrjeta të fiksuara të zbuluara		(b)						
	Rrjeta	Rrjeta	Njica		(b)						
			Rrjeta fikse të ankoruara		(b)						
					(b)						
			Mbrezhda		(b)						
					(b)						
	Trakte	Rrjeta me rrethim	Ciancole		(b)						
					(b)						
			Rrjeta me rrethim me		(b)						

			drita								
		Trakte	Trakte me tërheqje		(b)						
			Trakte fikse		(b)						
	Mjete të tjera	Mjete të tjera	Peshq ngjala qelqore	Ngjala qelqore	(b)						
	Te ndryshme (përcakto)	Te ndryshme (përcakto)									
	Aktivitete përveç peshkimit			Aktivitete përveç peshkimit							

Tabela 3

Speciet që do të mblidhen për peshkimin çlodhës argëtues

Zona	Species
Deti Mesdhe	Ngjalat (përfshirë edhe ujërat e ëmbla), elasmobrankët dhe speciet shumë migruese të ICCAT.

Tabela 4

Variablat e aktivitetit të peshkimit

	Variablat	Njësia
	Kapaciteti	
	Numri i anijeve	numër
	GT, kW, Mosha e anijes	numër
	Sforco	
	Ditë në det	ditë
	Orë tralimi (jo e detyrueshme)	orë
	Ditë peshkimi	ditë
	kW * Ditë peshkimi	numër
	GT * Ditë peshkimi	numër
	Numri i daljeve	numër
	Numri i operacioneve të peshkimit	numër
	Numri i rrjetave/ Gjatësia	numër/profesion
	Numri i grepave, Numri i linjave	numër
	Numri i kurtheve	numër
	Zbarkimet	
	Vlera e zbarkimeve totale dhe për llojet tregtare	lekë
	Pesha e gjallë e zbarkimeve totale dhe për llojet	ton
	Çmimet për llojet tregtare	lekë/kg

TË DHËNAT EKONOMIKE TË FLOTAVE

Tabela 5A

Variablat ekonomikë për flotën

Grupi i variablave	Variacioni	Specifikime për grumbullimin e të dhënave (1)	Njësia
Të ardhura	Vlera bruto e zbarkimeve	Transversale	lekë
	Të ardhura nga kontingjente ose nga të drejtat e peshkimit		lekë
	Subvencione të drejtpërdrejta (3)		lekë
	Të ardhura të tjera (4)		lekë
Kosto në lidhje me personelin	Pagesa për ekuipazhin (5)		lekë
	Vlera nga puna e papaguar (6)		lekë
			lekë

Kosto energjetike	Kosto energjetike (7)		lekë
Kosto riparimesh dhe mirëmbajtjeje	Kosto riparimesh dhe mirëmbajtjeje (8)		lekë
Kosto të tjera operative	Kosto të ndryshueshme (10)		lekë
	Kosto fikse (11)		lekë
	Taksa të vendndodhjes ose të drejta të tjera të peshkimit		lekë
Kosto të kapitalit	Amortizim vjetor		lekë
Vlera e kapitalit	Vlera e kapitalit fizik (13)		lekë
	Vlera e kontigjencës ose të të drejtave të peshkimit		lekë
Investime	Investime në kapitalin fizik (15)		lekë
Situata financiare	Raporti borxh/aktivitet (16)		%
Punësim	Ekuipazhi i punësuar (17)		numër
	EKP kombëtare (18)		numër
	EKP e harmonizuar (19)		numër
Flota	Numri	Transversale	numër
	LOA mesatare	Transversale	metra
	Pesha bruto mesatare	Transversale	GT
	Fuqia mesatare motorike	Transversale	kW
	Mosha mesatare	Transversale	vite
Sforco	Dite gjuetie	Transversale	dite
	Konsumi energjetik		litra
Numri i shoqërive të peshkimit	Numri i shoqërive të peshkimit (20)	Sipas madhësisë: 1. Një anije në pronësi 2. 2–5 anije në pronësi 3. mbi 5 anije në pronësi	numër
Vlera e prodhimit	Vlera e zbarkimeve për lloj	Transversal	lekë
	Çmimi mesatar për lloj (21)	Transversal	lekë

1) Variablat ekonomikë grumbullohen mbi baza vjetore në nivelin C3, shtojca V, me përjashtim të atyre të identifikuara si transversale që grumbullohen me nivele më të shpërbëra, sipas shtojcës VIII dhe frekuencës më të lartë;
2) përkufizimet miratohen me rregullore ministri;
3) përfshin pagesa të drejtpërdrejta, si: kompensim për dalje nga aktiviteti, kthim takash mbi karburantin ose pagesa të ngjashme amorfe. Përjashtohet mbështetja shoqërore dhe subvencione indirekte si akciza e karburantit ose mbi investimet;
4) përfshin të ardhura nga përdorime të tjera të anijes (peshkimi çlodhës argëtues, mbështetje për fushata kërkimore në det etj.), sikurse pagesa të sigurimeve për dëme të pësuara nga anijet ose mjete të peshkimit ose mbytje të saj;
5) përfshin edhe sigurimet shoqërore;
6) për shembull, kostoja e punës së pronarit të anijes;
7) me përjashtim të kostove të vajit;
8) kosto bruto për mirëmbajtje dhe riparim të anijes dhe mjeteve të peshkimit;
10) përfshin të gjithë faktorët e prodhimit të blerë (pajisje dhe shërbime) të lidhur me sforcon e peshkimit dhe/ose zënien;
11) përfshin faktorë të prodhimit të blerë, jo të lidhur me sforcon e peshkimit dhe/ose zënien (përfshirë edhe marrja me qira e mjeteve të peshkimit);
13) vlera e anijes (skafi, motori, pajisjet dhe mjetet që ndodhen në bord);
15) përmirësime te anijet/mjetet ekzistuese të vitit në fjalë;
16) përqindja e borxhit kundrejt vlerës totale të kapitalit;
17) numri i vendeve të punës në bord, që përfshin numrin mesatar të punëtorëve që punojnë për anijen dhe të paguar. Përfshin edhe personelin me kohë të pjesshme.
18) Ekuivalentë Kohe të Plotë (EKP), llogaritur sipas Kodit të Punës për orët e punës së anëtarëve të ekuipazhit (duke përjashtuar kohën e pushimit) dhe për orët e punës në tokë. Në rast se orët e punës janë më shumë se orari zyrtar, atëherë numri llogaritet 1, në rast të kundërt, është e barabartë me raportin orët e kryera/orët zyrtare.
19) sipas metodës së mësipërme;
20) llogaritur më 1 janar të çdo viti;
21) çmimi i llogaritur në peshë e gjallë.

TË DHËNAT EKONOMIKE TË FLOTËS

Tabela 5B

Segmentimi i flotës

		Klasë gjatësi (LOA)					
		0<6 m	6<12 m	12<18 m	18<24 m	24< 40 m	=< 40m
Anije aktive							
Zhvillojnë aktivitet me mjete aktive	Sfogliare						
	Anije tërheqëse fundore dhe/ose sciabica fundore						
	Tërheqëse pelagjike						
	Me rrethim						
	Draga						
	Me mjete të tjera aktive						
	Vetëm me mjete aktive shumëpërdoruese						
Zhvillojnë aktivitet me mjete pasive	Me grepa	(1)	(1)				
	Me rrjeta lundruese dhe/ose fikse						
	Kurthe ose kosha						
	Me mjete të tjera pasive						
	Vetëm me mjete pasive shumëpërdoruese						
Zhvillojnë aktivitet me mjete shumëpërdoruese	Anije me mjete aktive dhe pasive						
Anije joaktive							
1) për anijet më të vogla se 12 m mund të shpërbehen në vartësi të llojit të mjetit të peshkimit							

TË DHËNAT EKONOMIKE TË FLOTAVE

Tabela 6

Variablat socialë për sektorët e peshkimit dhe akuakulturës

Variabla	Njësia
Punësimi sipas gjinisë	Numër
Raporti i punësimit sipas gjinisë	Numër
Puna e papaguar sipas gjinisë	Numër
Punësimi sipas moshës	Numër
Punësimi sipas nivelit të shkollimit	Numër sipas nivelit të shkollimit
Punësimi sipas statusit të punësimit	Numër
Raporti i punësimit sipas gjinisë kombëtar	Numër

Tabela 7

Variablat ekonomike për sektorin e akuakulturës

Grup Variablat	Variablat	Specifike	Njësia
Të ardhurat	Të faturuara	Për specie	lekë
	Subvencione		lekë
	Hyrje të tjera		lekë
Kostot e personelit	Pagesat		lekë
	Vlera e punës së papaguar		lekë
Kosto e energjisë	Kosto e energjisë		lekë
Kosto që lidhen me lëndën e parë	Kosto të trajtimit		lekë
	Kosto të bazës ushqimore		lekë
Kosto riparimi e mirëmbajtje	Riparime e mirëmbajtje		lekë
Kosto të tjera operative	Kosto të tjera operative		lekë
Kosto kapitale	Amortizim kapital		lekë
	Kosto neto financiare		lekë
Kosto neto jo të zakonshme	Kosto neto jo të zakonshme		lekë
Vlera e kapitalit	Vlera totale e aktivit		lekë

Investime	Investime neto		lekë
Pasivi	Pasivi		lekë
Volumi i lëndes së parë	Trajtim		tonelatë
	Ushqim për peshqit		tonelatë
Volumet e shitjes	Kostoja e energjisë	Për specie	tonelatë
Punësimi	Numri i personave të punësuar		numri
	EKP Kombëtare		numri
Numri i sipërmarrjeve	Numri i sipërmarrjeve		numri

Tabela 8

Variablat mjedisorë për sektorin e akuakulturës

Variabla	Specifikimi	Njësia
Ilaçet ose trajtimet mjekësore të kryera	Për specie	Gram
Mortaliteti		Përqindje

Tabela 9

Segmentimi që do të zbatohet për mbledhjen e të dhënave të akuakulturës

	Teknikat e akuakulturës[2]				**Teknikat e moluskokulturës**			
	Kultivim në tokë			**Me kosha**				
	Njësi riprodhimi (inkubatorë) [3]	**Njësi për majmëri**	**Ndërmarrje me cikël të mbyllur**[4]	**Kosha notues** [5]	**Me kundërpesha**	**Me linjë galexhiant**	**Fundore** [6]	**Të tjera**
Salmonide								
Troftë								
Koce dhe levrek								
Krap								
Peshq të tjerë të familjes së krapit								
Specie të tjera detare								
Midhje								
Ostrike								
Vongola								
Molusqe të tjera								

Tabela 10

Fushatat kërkimore në det

[2] Segmentimi i aktivitetit kryhet në funksion të teknikës bazë të kultivimit.

[3]Njësitë e riprodhimit janë struktura të destinuara për riprodhimin artificial, në inkubatorë dhe trajtim gjatë fazave fillestare të jetës së gjallesave ujore. Për qëllime statistikore, inkubatorët janë të kufizuar për prodhimin e vezëve të fekonduara. Konsiderohet që stadet e mëtejshme të të vegjëlve të gjallesave ujore janë trajtuar në pellgjet e larvave. Në rastet kur inkubatorët dhe pellgjet e larvave janë të lidhura ngushtë, statistikat do t'i referohen në mënyrë unike stadit më të fundit të prodhimit (që në rastin tonë janë larvat).[COM(2006) 86 4].

[4] Sipërmarrjet që përdorin inkubatorë, njësitë e larvave dhe ato të majmërisë.

[5] Koshat janë struktura të mbyllura, me ose pa mbulesë, të përbëra nga rrjete apo material tjetër me vrima, që lejon shkëmbimin natyral të ujit. Të tilla struktura janë ato me galexhiante lundruese, të zhytura apo të ankoruara mbi fundin e objektit ujor, duke lejuar gjithmonë ujëkëmbimin nga poshtë. [COM(2006) 864

[6]) Teknikat fundore përfshijnë moluskokulturën në zonën ndërdallgore (direkt mbi taban apo të ngritura).

Emri i fushatës	Akronimi	Zona	Periudha	Speciet
Pan-Mediterranean Acoustic Survey	MEDIAS	GSA 1, 6, 7, 9, 10, 15, 16, 17, 18, 20, 22	Pranvere - verë	Pelagjikë e vegjël
International bottom trawl survey in the Mediterranean	MEDITS	GSA 1, 2, 3, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 22, 23, 25	Pranvere - verë	Peshqit fundorë

Tabela 11

Variablat ekonomikë dhe socialë për sektorin e industrisë përpunuese që mund të mblidhen mbi baza vullnetare

Grup Variablat	Variablat	Specifike	Njësia
Të ardhurat	Të faturuara	Për specie	lekë
	Subvencione		lekë
	Hyrje të tjera		lekë
Kostot e personelit	Pagesat		lekë
	Vlera e punës së papaguar		lekë
Kostoja e energjisë	Kostoja e energjisë		lekë
Kosto që lidhen me lëndën e parë	Kosto të trajtimit		lekë
	Kosto të bazës ushqimore		lekë
Kosto riparimi e mirëmbajtjeje	Riparime e mirëmbajtje		lekë
Kosto të tjera operative	Kosto të tjera operative		lekë
Kosto kapitale	Amortizim kapital		lekë
	Kosto neto financiare		lekë
Kosto neto jo të zakonshme	Kosto neto jo të zakonshme		lekë
Vlera e kapitalit	Vlera totale e aktivit		lekë
Investime	Investime neto		lekë
Pasivi	Pasivi		lekë
Volumi i lëndës së parë	Trajtim		tonelata
	Ushqim për peshqit		tonelata
Punësimi	Numri i personave të punësuar		numri
	Numri i orëve nga të punësuarit dhe të papunësuarit		numri
Numri i sipërmarrjeve	Numri i sipërmarrjeve	Për kategori në bazë të numrit të të punësuarve	numri